



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premiera/Office of the Prime Minister

Zyra për Çështje të Komuniteteve/Kancelarija za pitanja
zajednica/Office for Community Affairs



KONKURS

Zyra e Kryeministrit / Zyra për Çështje të Komuniteteve në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Norvegjisë, shpall konkurs për organizatat joqeveritare për zbatimin e projekteve **“Mbështetja e komunave të sapoformuara në veri të Kosovës përmes zhvillimit të arsimit, kulturës dhe rinisë”**.

QËLLIMI

Projekti ka për qëllim mbështetjen e komunave të sapoformuara dhe të shoqërisë civile përmes zhvillimit të arsimit, kulturës dhe rinisë, si dhe integrimin e komuniteteve jo shumicë.

PROCESI

ZÇK/ZKM përmes konkursit publik dhe të hapur, duke respektuar legjislacionin në fuqi në Kosovë, e me qëllim të zhvillimit të kulturës, rinisë dhe arsimit, do t'i ndaj një grant organizatës joqeveritare të përzgjedhur. Fituesi i grantit, me qëllim të mbështetjes së sektorit civil në veri të Kosovës, përmes konkursit të hapur, do të ndaj grante në shuma më të vogla për organizatat joqeveritare të cilat do të konkurrojnë me projekte që lidhen me kulturën, arsimin dhe rininë, njëkohësisht duke e respektuar legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Kriteret për ndarjen e mjeteve financiare në formë të garantëve për organizatat joqeveritare do t'i përcaktojnë ZÇK /ZKM dhe Ambasada e Norvegjisë.

Kohëzgjatja e projektit: 15 nëntor 2014 - 15 shtator 2015

KRITERET E PËRGJITHSHME PËR DORËZIMIN E KËRKESAVE:

1. E regjistruar (të posedoj certifikatë të regjistrimit të Republikës së Kosovës)
2. Numri fiskal
3. Organizata duhet të ketë qenë aktive paraprakisht për më shumë se 6 vjet
4. Organizata duhet të jetë në gjendje të tregoj që ka edhe burime të tjera të financimit ose që merr mbështetje nga donatorë të tjerë
5. Të ketë eksperiencë në punë në veri të Kosovës
6. Të ketë eksperiencë në punë me komunitetet jo shumicë në Kosovë

7. Në fushëveprim të punës ka për qëllim zhvillimin e shoqërisë civile

FONDI I PROJEKTIT

- ZKM do të ndajë 80,000 euro nga fondi i dhënë nga Ambasada e Norvegjisë, i cili ka për qëllim zhvillimin dhe integrimin e komuniteteve jo shumicë
- Pagesat do të bëhen në euro ndërsa bartja do të bëhet ekskluzivisht përmes transaksionit bankar.

DOKUMENTET PËRCJELLËSE PËR KËRKESËN:

1. Formulari i kërkesës duhet të jetë i plotësuar në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës (serbisht/shqip) në formë përmbledhëse dhe me të dhëna të sakta;
2. Kopje e letërnjoftimit/pasaportës së vlefshme të Kosovës të personit të autorizuar i cili e përfaqëson organizatën;
3. Certifikatë të regjistrimit të Republikës së Kosovës;
4. Certifikatë të numrit fiskal;
5. Dëshmi që organizata është aktive për më gjatë se 6 vjet
6. Dëshmi për tatim të paguar
7. Kartelë bankare të skanuar (në sistemin e Republikës së Kosovës)
8. Dëshmi për burime të tjera të financimit (mbështetja e donatorëve të tjerë)
9. Dëshmi për eksperiencën e punës në veri të Kosovës
10. Dëshmi për punën me komunitet jo shumicë në Kosovë

Formularin e kërkesës mund ta shkarkoni nga: www.kryeministri-ks.net ose www.kryeministri-ks.net/zck

Organizatave të cilat konkurrojnë duhet të dorëzojnë dokumentet e tyre (në zarf të mbyllur) në këtë adresë: Rr. Nëna Terezë, Ndërtesa e Qeverisë së Kosovës, Kati VI, Zyra nr. 606, ose të dërgojnë dokumentet e skanuara në e-mail adresën në vijim: zck-kpz-grants@rks-gov.net

Afati për dorëzimin e kërkesave fillon nga data e shpalljes, 11.10.2014 dhe do të vazhdojë për 14 (katërbëdhjetë) ditë, gjer më 25.10.2014, në orën 16.00.

Në afat prej 14 ditësh nga data e mbylljes së konkursit, ZÇM do të shqyrtoj kërkesat e dorëzuara dhe do të informoj organizatat e përzgjedhura që janë përzgjedhur në rrethin e ngushtë. Zyra për Çështje të Komuniteteve pastaj do të formoj një komision dhe do të përzgjedhë organizatën e cila do të zbatoj projektin.